



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-06  
**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Për:** Gjykatësin e Procedurës Paraprake  
Gjykatësi Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Parashtrori:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 17 nëntor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Njoftim i emërimit të bashkëmbrojtësit për Hashim Thaçin**

**me një shtojcë konfidenciale**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**

Dejvid Hupër

1. Në pajtim me rregullën 26(1) të Rregullores<sup>1</sup>, nëpërmjet këtij njoftimi Administratorja informon Gjykatësin e Procedurës Paraprake për miratimin e bashkëmbrojtësit shtesë për zotin Hashim Thaçi (“z. Thaçi”).
2. Më datë 5 nëntor 2020, Administratorja e emëroi zotin Dejvid Hupër QC si mbrojtës për z. Thaçi në pajtim me pjesët 12 dhe 13 të Direktivës për Mbrojtësit.<sup>2</sup>
3. Më datë 9 nëntor 2020, Administratorja e informoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake për miratimin nga Administratorja të zotit Dastid Pallaska si bashkëmbrojtës për z. Thaçi, në pritje të vendimit përfundimtar për pranimin e tij në Listën e Mbrojtësve.<sup>3</sup>
4. Më datë 16 nëntor 2020, Administratorja e informoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake për miratimin nga Administratorja të zotit Samuel Blom-Kuper si bashkëmbrojtës për z. Thaçi.<sup>4</sup>
5. Më datë 17 nëntor 2020, mbrojtësi e informoi shefin e Zyrës së Mbrojtjes se dëshiron të ndihmohet nga zoti Pier-Riçard Prosper (Pierre-Richard Prosper) si bashkëmbrojtës shtesë dhe paraqiti dokumentacionin përkatës në pajtim me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit.
6. Më datë 17 nëntor 2020, shefi i Zyrës së Mbrojtjes, pas konsultimit me Administratoren, e pranoi me kusht z. Prosper në Listën e Mbrojtësve, në pajtim me pjesën 7(2) të Direktivës për Mbrojtësit.
7. Më datë 17 nëntor 2020, Administratorja e miratoi z. Prosper si bashkëmbrojtës për z. Thaçi në pajtim me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit, në pritje të vendimit përfundimtar mbi pranimin e z. Prosper në Listën e Mbrojtësve.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-03/Rev3/2020, (“Rregullorja”); *shih edhe* Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015, nenet 21(4), 21(5), 34(7) dhe 41(4)(b).

<sup>2</sup> Direktivë për Mbrojtësit, KSC-BD-04, 6 nëntor 2017.

<sup>3</sup> Njoftim i emërimit të bashkëmbrojtësit për Hashim Thaçin, KSC-BC-2020-06/F00066, 9 nëntor 2020, publik.

<sup>4</sup> Njoftim i emërimit të bashkëmbrojtësit për Hashim Thaçin, KSC-BC-2020-06/F00080, 16 nëntor 2020, publik.

<sup>5</sup> *Shih* Shtojca 1, Letër miratimi për përzgjedhjen e bashkëmbrojtësit, KSC/REG/IOR/3384, 17 nëntor 2020.

8. Ky parashtim parashtrohet me klasifikimin publik, ndërsa shtojca 1 klasifikohet me parashtimin konfidencial në pajtim me rregullën 82(1)(b) dhe (3) të Rregullores, duke qenë se përmban të dhëna personale për mbrojtësin dhe bashkëmbrojtësit.

**Numri i fjalëve (në origjinal): 273**

/nënshkrimi/

---

**Dr. Fidelma Donlon**  
**Administratore**

E martë, më 17 nëntor 2020  
Hagë, Holandë